

Në bazë të nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) dhe nenit 47 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt. 14.12.2017, bjen këtë:

V E N D I M

MBI FORMIMIN E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

I.

Formohet Komiteti për Politikë dhe Financa i Kuvendit të Komunës së Deçanit, në këtë përbërje:

1. Haki Shehaj, kryesues i Komitetit-AAK,
2. Valdet Nuraj, anëtar-AAK,
3. Albane Avdiu, anëtare-AAK,
4. Kushtrim Loshaj, anëtar-AAK,
5. Fatmir Kurmehaj, anëtar-LDK,
6. Mon Selmonaj, anëtar-PDK,
7. Kastriot Lokaj, anëtar-LVV.

II.

Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, Kornizën afatmesme buxhetore, planin vjetor të prokurimit, rregulloret komunale, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal, si dhe marrjen e raporteve nga kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në kuvendin e komunës.

III.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës.

Me Vendim njoftohen:

- Të emruarit në pikën I. Të Vendimit,
- MAPL, dhe
- Arhivi i KK Deçan.

01.Nr.I-5

Deçan,dt.14.12.2017



Kryesuesi:
Dr.Haki Shehaj

HYRESE-ULAZMA-INGOING	
REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVA	
KOMUNA E DEÇANIT • OPSTINA DEÇANE • DEÇANI MUNICIPALITY	
Nga: Gj. Fron:	Nr. Prot: Sr. Prot: Prot. No:
KK Deçan, As	37851
Nr. i ftoqev: Stranica Pages:	Data: Datum: Date:
01	14.12.2017
DEÇAN DEÇANE	



Në bazë të nenit 53 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 47 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e vet të mbajtur me dt. 31.01.2018, bjen këtë :

V E N D I M

MBI FORMIMIN E KOMITETIT TË KOMUNITETEVE

I.

Formohet Komiteti i Komuniteteve pranë Kuvendit të Komunës së Deçanit në këtë përbërje:

1. Hurka Halilaj, përfaqësuese e Komunitetit Boshnjak,
2. Elmir Nezaj, përfaqësues i Komunitetit Egjiptian
3. Jetmir Belaj, përfaqësues i Komunitetit Rom,
4. Boshko Çiriç, përfaqësues i Komunitetit Serb,
5. Millanka Popoviq, përfaqësuese e Komunitetit Malazez,
6. Fekri Qufaj (AAK), nga Asambleja,
7. Opozita nga Asambleja në këtë Komitet do të përfaqësohen me rrotacion: Besnik Hulaj (LDK) ne vitin 2018 dhe 2019, Kestrim Avdimetaj (PDK) ne vitin 2020 dhe Natyra Kuçi (VV) ne vitin 2021.

Komiteti do ta zgjedhë Kryesuesin e vet në mbledhjen e parë që do ta mbajnë, e cila mbledhje do të ftohet nga Kryesuesi i Kuvendit.

II.

Komiteti i Komuniteteve është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për tu siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht.

Komiteti gjithashtu i rekomandon kuvendit të komunës masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për tu avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të drejtave të komuniteteve brenda komunës.

III.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

Me Vendim njoftohen:

- Të emruarit në pikën I. Të Vendimit dhe
- Arhivi.


01.Nr.I-8

Deçan, dt. 31.01.2018

HYRESE-LILAZNA-INGOING	
REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVA	
KOMUNA E DEÇANIT • OPSTINA DEÇANE • DEÇANI MUNICIPALITY	
Nr. Prot: 3518	Prot. No:
Od: R.K. Deçan	Prot. No:
From: R.K. Deçan	Prot. No:
Nr. i faqeve: 01	Data: 05.02.18
De: Shehajt	Date: 05.02.18
No. Pages:	DEÇAN, DEÇANE



Kryesuesi:
Haki Shehaj



Në bazë të nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) dhe nenit 47 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt. 29.06.2018, bjen këtë:

V E N D I M

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

I.

Ndryshohet dhe plotësohet pika nr.I.7 e Vendimit të dt. 14.12.2017, për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa pranë Kuvendit të Komunës së Deçanit.

Natyra Kuçi, emrohet anëtare e Komitetit për Politikë dhe Financa në vend të Kastriot Lokaj, nga i njëjti subjekt politik –Partia Socialdemokrate (ish Vetëvendosje).

II.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës.

Me Vendim njoftohen:

- E emruara në pikën I. Të Vendimit,
- MAPL, dhe
- Arhivi i Komunës së Deçanit.

01.Nr.VII-2

Deçan,dt.29.06.2018

HYRËSE/LUSCINA-ИВРИСНИК	
REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA	
KOMUNA E DEÇANIT - OPSTINA DEÇANE - DEÇANI MUNICIPALITY	
Nga: KK Aegani AS	Mr. Prot: 19232
Dë: [Blank]	B: Prot: [Blank]
From: [Blank]	Prot. No: [Blank]
Nr. i faqeve: 01	Data: 29.07.18
Rr. Stranica: [Blank]	Date: [Blank]
No. Pages: [Blank]	[Blank]
DECAN DEÇANE	



Kryesuesi i Kuvendit
Haki Shehaj



Në bazë të nenit 53 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) dhe nenit 47 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt. 27.09.2018, nxjerrë këtë:

V E N D I M

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E KOMITETIT TË KOMUNITETEVE

I.

Ndryshohet dhe plotësohet pika nr.I.1 e Vendimit të dt. 31.01.2018, për formimin e Komitetit të Komuniteteve, pranë Kuvendit të Komunës së Deçanit.

Hedije Kuçi, emrohet anëtare e Komitetit të Komuniteteve në vend të Hurka Halilaj, nga i njëjti komunitet- përfaqësuese e Komitetit Boshnjak .

II.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës.

Me Vendim njoftohen:

- E emruara në pikën I. Të Vendimit,
- MAPL, dhe
- Arhivi i Komunës së Deçanit.

01.Nr.IX-8

Deçan,dt.27.09.2018

DILESE-IZLAZNA-OUTGOING	
REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVA	
KOMUNA E DEÇANIT • OPSTINA DEÇANE • DECANI MUNICIPALITY	
Organizim Org. Jashme Org. Unit	K komunice
Nr. i shteteve N. Seranca No. Post	01
Nr. Prot. Bc. Prot. Prot. Nr.	31454
Data Dahet Date	04.10.18
DECAN DECANI	



Kryesuesi i Kuvendit
Haki Shehaj



Në bazë të nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) dhe nenit 48 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt. 02.03.2020, bie këtë:

V E N D I M

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

I.

Ndryshohet dhe plotësohet pika nr.I.-5 e Vendimit të dt. 14.12.2017, për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa pranë Kuvendit të Komunës së Deçanit.

Albesa Cacaj, emrohet anëtare e Komitetit për Politikë dhe Financa në vend të Fatmir Kurmehaj, nga i njëjti subjekt politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK).

II.


Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës.

Me Vendim njoftohen:

- E emruara në pikën I. Të Vendimit,
- MAPL, dhe
- Arhivi i Komunës së Deçanit.

01.Nr.II-8/2

Deçan,dt.02.03.2020



Kryesuesi i Kuvendit
Haki Shehaj